



Mbi
15
vjet garanci

Cilësi e garantuar

Filmat LLumar prodhohen nga Eastman Chemical Company në SHBA. Me më shumë se 60.000 m² hapësirë, fabrika e prodhimit ka kapacitet të mjaftueshëm, për të përmbushur nevojat e tregut me gamën më të gjerë të filmave për trajtimin profesional të xhamave. Më shumë se 50 vjet përvojë dhe zbatimimi i rreptë i kontrollit të cilësisë na sigurojnë cilësi të shkëlqyer, bazuar në të cilën produktet LLumar ofrojnë garanci më të gjatë se prodhuesit e tjerë në këtë industri duke qënë lider në tregun botëror.

Filmat profesionalë dhe me cilësi të lartë LLumar, mund të gjenden të instaluar në shumë ndërtesa të njohura në të gjithë botën si Buckingham Palace apo Vatikan. Ambasada, hotele, spitale, ndërtesa qeveritare, banka, magazina, restorante, muze dhe ndërtesa për zyra – të gjithë përfitojnë nga avantazhet e filmave LLumar.

Film xhami me performancë të lartë
Komoditet pa kompromis



Dekor dhe Design

Hapësirat për zyra dhe biznese mund të dizajnohen me specifika të veçanta individuale dhe ndarjet me xham mund të pajisen me efektet dekorative të dëshiruara. Për këto aplikime LLumar ofron si filmat transparente të ngjyrosur ashtu edhe ato të modeluar ose plotësisht të ngjyrosur.

Filma sigurie

Duke instaluar Keta Filma xhami ju mbron njerëzit nga copat e xhamit nëse ndodh që të thyhet. Kjo do të thotë që një xham edhe pasi të jetë vendosur në objekt, mund të përmirësohet me këta filma, për të arritur standartet ligjore, EN 12600, (psh në shkolla, qendra të kujdesit shëndetësor, ambiente sportive apo ndërtesa publike).

Filmat e sigurisë LLumar rrisin ndjeshëm rezistencën ndaj thyerjes së xhamit, vandalizmit apo valëve të shpërthimeve nga lëndët plasëse. Ata janë të kategorizuar si xhama sigurie të laminuar (EN 356, GSA Niveli 2).




Partner i LLumar – www.LLumar.com

EASTMAN



© 2014 Eastman Chemical Company. LLumar® and the LLumar® logo are trademarks of Eastman Chemical Company or one of its wholly owned subsidiaries. The © used herein denotes registered trademark status in the US; marks referenced herein may also be registered internationally. Visual renderings are for illustrative purposes only; actual appearance of windows treated with film may vary. All rights reserved. No liability is accepted for errors. Version 4.00.0314-AL



Mbi
15%
kursim energjie

LLumar

Dielli luan një rol thelbësor për jetën në tokë, por shumë diell mund të jetë i pakëndshëm, madje edhe i dëmshëm. Rrezatimi UV i pafiltruar është shkatërrimtar, dhe jo vetëm për lëkurën e njeriut. Montimi i filmave specialë në sipërfaqen e xhamit ofron mbrojtje efektive kundër pasojave të dëmshme të diellit si në ndërtesat e reja edhe në ato ekzistuese. Filmat LLumar arrijnë të reflektojnë më tepër se 80% të energjisë diellore, kundërshtojnë 99% të rrezeve të dëmshme Ultraviolet si dhe mund të rritin mbi 40% efikasitetin e izolimit termik të xhamit duke mos lejuar humbjen e nxehtësisë gjatë dimrit.

Kontroll solar

Kur xhami është i pajisur me trajtim për izolim termik, i cili ul kostot e ngrohjes gjatë dimrit, ndërtesat e ruajnë nxehtësinë gjatë verës. Filmat LLumar ulin koeficientin e akumulimit të nxehtësisë diellore, duke zvogëluar kështu sasinë e ngrohjes së tepërt madje edhe kur xhami i përdorur është me trajtim të izolimit termik.

- Reduktim i temperaturës së brendshme
- Kushte optimale të punës
- Redukton kostot për ngrohje dhe për ftohje
- Rritje e produktivitetit me më pak lodhje

Kursim i energjisë

Kondicionimi i ajrit gjatë verës dhe ngrohja gjatë dimrit përbëjnë një kosto të madhe si për bizneset edhe për familjarët. Filmat LLumar ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme vlerën "U" dhe reduktojnë në mënyrë drastike humbjen e nxehtësisë në dimër dhe depërtimin e nxehtësisë gjatë verës.

- Izolim termik dhe mbrojtje solare gjatë gjithë vitit
- Redukton kostot për ngrohje dhe për ftohje
- Mbrojtje e mjedisit përmes reduktimit të energjisë së përdorur dhe uljes së shpenzimeve

Mbrojtje ndaj rrezeve UV

Filmat LLumar pengojnë rrezet UV deri në masën 99.9%. Kjo ju mundëson të mbani produkte në vitrinat e dyqaneve pa pasur probleme të venitjes së ngjyrave nga dielli. Filmat për mbrojtje nga rrezet UV përdoren edhe në muze, për të mbrojtur veprat e artit dhe objekte të tjera historike kulturore. Filmat LLumar mund të ulin në mënyrë të ndjeshme sasinë e rrezeve UV që arrijnë në trupin tonë. Risku që rrezet UV të dëmtojnë lëkurën dhe sytë ulet në mënyrë të ndjeshme. Përdorimi i këtyre filmave është shumë i rëndësishëm për familje

me fëmijë të vegjël, duke qënë se lëkura dhe sytë e tyre janë më të ndjeshëm.

- Mbrojtje nga venitja e objekteve me vlerë
- Mbrojtje e shëndetit nga rrezet UV që shkaktojnë kancerin e lëkurës



Mbrojtje ndaj shkëlqimit verbues

Kushtet e vendit të punës bëhen më të vështira për shkak të shkëlqimit verbues të dritës natyrore dhe reflektimit mbi ekranet e kompjuterave.

- Rritje e produktivitetit me më pak lodhje
- Mbrojtje për sytë

Mbrojtje e privatësisë

Zyrat e ndara me xhama krijojnë një atmosferë të hapur pune, por shpesh mund të bëhet shqetësim dhe pengesë në punë ndërhyrja e syve kureshtarë. Filmat dekorativë dhe pasqyrë përdoren për të minimizuar këtë efekt dhe për të mbrojtur privatësinë tuaj. Disponojmë dhe filma pasqyrë vetëm në një krah (one way mirror) në të cilat njerëzit mund të shohin nga brenda-jashtë, por jo e kundërta.

- Filma për mbrojtje të pjesshme ose të plotë të privatësisë
- Filmat ruajnë privatësinë ndërkohë që lejojnë të shikosh qartë nga brenda – jashtë ambientit